



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 3, datë 07.03.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10⁴⁵)

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1.Edison Kapaj | 16.Liljana Breshani |
| 2.Sokol Kushta | 17.Aurora Qarri |
| 3.Ardian Musta | 18.Roland Strakosha |
| 4.Vullnet Bilbilaj | 19.Novrus Rrokaj |
| 5.Eglantina Aliaj | 20.Brikena Puka |
| 6.Rajmonda Zoto | 21.Edlira Kapllanaj |
| 7.Brikena Sika | 22.Shkëlqim Leskaj |
| 8.Besmir Brahimi | 23.Ervis Moçka |
| 9.Myzafer Elezi | 24.Grigor Dede |
| 10.Gjergji Nika | 25.Endri Hyseni |
| 11.Simbol Pazaj | 26.Briseida Çakërri |
| 12.Englantina Imeraj | 27.Illir Aliaj |
| 13.Frosina Qyrdeti | 28.Bujar Osmënaj |
| 14.Vjola Xhafaj | 29.Elpiniqi Mërkuri |
| 15.Lorel Canaj | 30.Simo Petromilo |

Mungojnë :

- 1.Elca Bezhani
- 2.Anisa Ceno
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Jerina Dervishaj

- 5.Marsela Dashi
- 6.Mujo Shakaj
- 7.Evis Allushi
- 8.Eda Begaj
- 9.Arsen Belaj
- 10.Geron Gunbardhi
- 11.Liri Dëma
- 12.Arjan Isufi
- 13.Dikens Bushaj
- 14.Anxhela Shenaj
- 15.Refie Laze
- 16.Erëmal Arapi
- 17.Atird Hoxha
- 18.Eneida Vera
- 19.Klodian Xhyheri
- 20.Alta Haluci
- 21.Ledja Shollaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 3/1, datë 07.03.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri - Mirëmëngjes të gjithëve!

Faleminderit që keni ardhur sot. Uroj sot të gjithë mësuesit në festën e tyre, për punën që bëjnë për edukimin e brezit të ri , si dhe të uroj festën e 8 marsit, vajzave, nënave dhe grave.

Faleminderit që ekzistoni.

Faleminderit që erdhët sot në këtë mbledhje jashtë radhe, thirrur nga kryetari i bashkisë.

Për mosrealizim të kuorumit , mbledhja do të shtyhet për një moment të dytë.

Faleminderit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 3/1, datë 13.03.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10³⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Endri Hyseni | 22.Besmir Brahimi |
| 2.Simo Petromilo | 23.Bujar Osmënaj |
| 3.Ardian Musta | 24.Eda Begaj |
| 4.Ervis Moçka | 25.Englantina Imeraj |
| 5.Simbol Pazaj | 26.Edlira Kapllanaj |
| 6.Edison Kapaj | 27.Myzafer Elezi |
| 7.Ledja Shollaj | 28.Liljana Breshani |
| 8.Jerina Dervishaj | 29.Atird Hoxha |
| 9.Sokol Kushta | 30.Klodian Xhyheri |
| 10.Vullnet Bilbilaj | 31.Roland Strakosha |
| 11.Illir Aliaj | 32.Grigor Dede |
| 12.Gjergji Nika | 33.Alta Haluci |
| 13.Novrus Rrokaj | 34.Brikena Sika |
| 14.Brikena Puka | 35.Evis Allushi |
| 15.Briseida Çakërri | 36.Eneida Vera |
| 16.Geron Gunbardhi | 37.Elpiniqi Mërkuri |
| 17.Frosina Qyrdeti | 38.Arsen Belaj |
| 18.Anisa Ceno | 39.Shkëlqim Leskaj |
| 19.Eglantina Aliaj | 40.Elca Bezhani |
| 20.Rajmonda Zoto | 41.Aurora Qarri |
| 21.Vjola Xhafaj | |

Mungojnë :

- 1.Gëzim Çapoj
- 2.Marsela Dashi
- 3.Lorel Canaj
- 4.Mujo Shakaj
- 5.Arjan Isufi
- 6.Liri Dëma
- 7.Dikens Bushaj
- 8.Erëmal Arapi
- 9.Anxhela Shenaj
- 10.Refie Laze



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 3/1/1, datë 13.03.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes të gjithëve!

Faleminderit që jeni prezent në këtë takim, pasi herën e kaluar nuk ishte kuorumi.

Uroj që, sot njëzëri të miratojmë projektvendimin për ngritjen e Muzeut Hebraik, propozuar nga kryetari i bashkisë (Lexon titullin e projektvendimit)

Muzeu që do të ndërtohet në Vlorë, është muzeu i parë Hebraik në Shqipëri dhe në Ballkan dhe do të jetë një vlerë e shtuar. Ka pas dhe debate në lidhje me zënien e Muzeut Etnografik..Për një prshkrim të situatës të na relatojë drejtori i urbanistikës, apo drejtori juridik.

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi, është për dhënien, shprehjen e dakortësisë për sipërfaqen 458m². Ky vejn pas miratimit të Memorandumit , në mbledhjen e kaluar.

Z.Klaudio Mehmeti - Një prezantim të shkurtër. Falënderojmë gjithë ata që kanë marrë pjesë dhe asistuar në këtë projekt. Kemi marrë një shkresë nga Drejtori i Monumenteve të Kulturës. Në material, (spjeron) Muzeu Etnografik, nuk do të preket, është skeda nr 158. Është skeda me nr 162, banesa ngjitur, ku lejohet ndërhyrje. Banesa pranë ish-Klubit Labëria , do të preket, vetë Klubi Labëria, nuk do të preket.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Përsa i përket kësaj mbledhje, është mbledhje e thirrur nga kryetari i bashkisë..Është mungesë e theksuar e administratës së kryetarit të bashkisë, i cili mungon, janë prezentë vetëm drejtorët. Edhe unë e kisha si shqetësim dhe i paqartë, në lidhje me mos prekjen e Muzeun Etnografik që për fat të keq është lënë jashtë rikonstruksionit.

Është e pafalshme që Muzeu Etnografik, të ngelet jashtë rikonstruksionit. Janë sende me vlerë historike të jashtëzakonshme, që rrinë në atë gjendje.

Ne si grup kemi bojkotuar , pasi në konferencën e kryeatrëve është vendosur datë apriori, për mbledhjen e datës 7 mars. Janë 3-4 vite që diskutohet ky projekt .. Është mungesë e theksuar serioziteti e kryetarit të bashkisë. Meqenëse, e thërret kryetari i bashkisë këtë mbledhje, duhet të ishte i pranishëm.

Z.Ervis Moçka – Për sqarim, kryetari është duke ardhur, mbledhja u la të fillonte, është duke ardhur, pra, ka përgjegjësi dhe do vijë të relatojë.

Shqetësimi është i drejtë , ashtu sikurse juve , për Klubin Labëria, sot Muzeu Etnografik , edhe ne e kishim këtë shqetësim, por Muzeu Etnografik nuk çënohet si dhe i drejtë dhe shqetësimi për rikonceptimin e Muzeut Etnografik. I bëjmë thirrje drejtorisë së urbanistikës për rikonceptimin e këtij muzeu.

Përsa i përket projektvëndimit, nga administrata, ishte e qartë, kjo pasur nuk preket . Janë dy numra të tjera pasurish..Kjo do të kthehet në një zonë atraksioni, për gjithë qytetin, për një dimension zhvillimor.

Znj. Alta Haluci – Para se ta miratojmë, dhe e mbështesim këtë projektvëndim. Dua të theksoj dhe shprehim nderim për 3 kongresmenë amerikanë, zotërinjtë Eliot Engell ; Benxhamin Gilman dhe Tom Lantosh. Të tre këta kongresmenë dhe senatorë amerikanë , kanë kontribuar dhe mbështetur në Çështjen Shqiptare në Ballkan dhe Elie Viesel , nobelisti për paqen me shkrimin për gruan e hekurit për lirinë e Kosovës.

Është një ogur i mirë, dhe urë bashkim vlerash, nderimi dhe mirënjohje midis vlonjatëve, shqiptarëve dhe hebrenjve.

Meqenëse sot po miratojmë këtë projektvëndim, propozoj, pasi kam depozituar një projekt propozim për Muzeun e Flamurit, tek Shtëpia e Pavarësisë. Muzeu i Flamurit, ka një zë të rëndësishëm, është identiteti i Vlorës dhe Kombit Shqiptar, për kulturën dhe, jo vetëm. Përsa i përket pjesës së trashëgimisë labe , dëshmi e vlerave kombëtare. Për të dyja këto projekte të japim “ok”. Jam pro, ngritjes së Muzeut Hebraik.

Znj.Elpiniaq Mërkuri - Nëqoftëse, s;ka pyetje apo diskutime të tjera...

Z.Klodian Xhyheri – Paraprakisht me gjithë këshilltarët , që ka kryetari i bashkisë, duhet të mbajnë një kalendar, data 27 janar , është Dita e kujtesës së viktimave të Holokaustit . Në Vlorë i mbrojtën hebrenjtë dhe kjo ka lidhje me një kod të shenjtë, me besën. Jam krenar për këtë, se krahas 34 familjeve , emri i familjes time, është në murin e nderit në Tel Aviv. Janë 2 familje të prekura direkt këtu në këshill, familja Çakërrri dhe Xhyheri. Për sa më lartë, për datën 27 janar, të bëhej një përkujtimore. Jam pro këtij projektvëndimi.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Fjalë shumë të bukura në lidhje me miqësinë e popullit vlonjat dhe atij izraelit.

Z.Ervis Moçka – Ishte thjesht shtyrje dhe nga ana jonë e asaj mbledhje, pasi kjo duhej të votohej dhe nga grupet e tjera. Të votojmë unanimisht për ngritjen e këtij muzeu.Kjo është dëshira e të gjithëve.

Z.Ermal Dredha – Kemi bërë dëgjese publike, dhe kryesisht është për pjesën e komunitetit që banon aty. Nuk është vetëm iniciativa jonë, ka vlerë historike. Investim rreth 9 milion euro...Qendra Historike, ka marrë një kontekst tjetër , ka vlera historike. Qeveria i ka dhënë gjithmonë mbështetje besës dhe bujarisë së banorëve tanë me atë hebre. Projekti ishte gati , thjesht do shtohet një pjesë 458m2.

Nuk ma do mendja që të jetë njeri kundër, për këtë muze, për vetë vlerën që mbartin..., investim strategjik mund të quhet.

Znj. Alta Haluci – Jo vetëm ne kemi bërë për popullin hebre, por dhe emra të sipkatur , kanë dhënë ndikimet e tyre. Dakortësia është nga ne,...por kam bërë 2 propozime;

1.Për Muzeun e Flamurit dhe,

2.Muzeu për Iso Polifoninë Labe.

Janë 2 propozime që të shihen në të ardhmen. Jemi dakort.

Znj.Liljana Breshani – Kam pas fatin që në shtatorin e kaluar, me kryetaren e këshillit , të ishim të pransishëm në shtetin hebraik, në festat e tyre. Paraqitja e këtij projekti të muzeut,.. ne kërkuam nga të gjitha familjet që kishin jetuar në Vlorë, si Kohen, Solomoni, materiale për të plotësuar këtë muze. Më vjen mirë që jam prezent sot këtu dhe pro për ta miratuar , bërjen e këtij muzeu.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Nëqoftëse, nuk keni gjë tjetër, e kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 41vota (anëtarë të pranishëm)

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Kalojmë në pikën , “Të ndryshme “ . Ka diçka ?

-Jo.

Faleminderit të gjithëve. Gëzuar Ditën e Verës !

Faleminderit!